



Republika e Kosovës  
Republika Kosova-Republic of Kosovo  
*Qeveria - Vlada - Government*  
Zyra e Kryeministrit -Ured Premijera -Office of the Prime Minister  
*Agjencia e Statistikave të Kosovës - Agencija Statistike Kosova - Kosovo Agency of Statistics*

## Seria 5: Statistikat Sociale

# Rezultatet e Anketës së Buxhetit të Ekonomive Familjare 2011



ENTI I STATISTIKËS SË KOSOVËS  
ZAVOD ZA STATISTIKU KOSOVA  
STATISTICAL OFFICE OF KOSOVA





Republika e Kosovës  
Republika Kosova-Republic of Kosovo  
*Qeveria - Vlada - Government*  
Zyra e Kryeministrit -Ured Premijera -Office of the Prime Minister  
*Agjencia e Statistikave të Kosovës - Agencija Statistike Kosova - Kosovo Agency of Statistics*

## Seria 5: Statistikat Sociale

# Rezultatet e Anketës së Buxhetit të Ekonomive Familjare 2011



ENTI I STATISTIKËS SË KOSOVËS  
ZAVOD ZA STATISTIKU KOSOVA  
STATISTICAL OFFICE OF KOSOVA

Botuesi: *Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK)*

Data e botimit: Qershor 2012

© : Agjencia e Statistikave të Kosovës

Riprodhimi autorizohet nëse tregohet burimi.

E shtypur nga: K.G.T, Prishtinë, Kosovë

Informata të shumta janë në dispozicion në internet,  
ku mund të qaseni përmes veb-faqes së ASK-së  
në internet: <http://esk.rks-gov.net>

## **P a r a t h ë n i e**

Agjencioni Statistikor i Kosovës (ASK), përkatësisht Departamenti i Statistikave Sociale (DSS) është duke zhvilluar Anketën mbi buxhetin e ekonomive familjare (ABEF), prej vitit 2002.

Qëllimi i publikimit të rezultateve të Anketës së buxhetit të ekonomive familjare 2011, është që të ofrojmë të dhëna statistikore lidhur me të ardhurat, konsumin si dhe të dhëna statistikore për çështjet tjera të ngjashme që kanë të bëjnë me standardin jetësor të ekonomive familjare në Kosovë.

Në këtë publikim janë paraqitur rezultatet në formë përmbledhëse për konsumin, shpenzimet dhe të ardhurat e ekonomive familjare për periudhat 2009-2011.

Përmes këtij publikimi është synuar zbutja e mungesës së informacioneve në fushën e standardit jetësor të ekonomive familjare në Kosovë. Besojmë se ky publikim do të shërbejë si një bazë e dobishme referuese për të gjithë shfrytëzuesit e të dhënave statistikore.

Përkrahje profesionale për zhvillimin e ABEF, kanë ofruar Organizata Suedeze (SIDA) si dhe Banka Botërore (BB). Falënderojmë ekspertët e këtyre organizatave për kontributin e tyre. Nga stafi tjetër i ASK-së në nivel rajonal, falënderojmë punëtorët e zyrave rajonale që kanë kontribuar në grumbullimin e të dhënave të ABEF .

Komentet, vërejtjet, sugjerimet dhe propozimet tuaja lidhur me këtë publikim janë të mirëseardhura dhe ato të dërgohen në adresën elektronike: [social@rks-gov.net](mailto:social@rks-gov.net).

Publikim përgatitën:

1. Mr. sc. Bashkim Bellaqa – Drejtor i Departamentit të Statistikave Sociale,
2. Emina Deliu – Shefe e Sektorit të Standardit Jetësor,
3. Besa Haqifi – Zyrtare e lartë e Sektorit të Standardit Jetësor dhe
4. Ahmet Cakolli - Zyrtar për dizajnim.

Qershor, 2012

Kryeshefi Ekzekutiv i ASK-së,  
Isa Krasniqi

## Lista e shkurtesave

ABEF	-	Anketa e Buxhetit të Ekonomive Familjare
ASK	-	Agjencia e Statistikave të Kosovës
BB	-	Banka Botërore
BE	-	Bashkimi Evropian
DSS	-	Departamenti i Statistikave Sociale
IÇK	-	Indeksi i Çmimeve Konsumuese
KKIQ	-	Klasifikimi i Konsumit Individual sipas Qëllimit
LLK	-	Llogaritë Kombëtare
SIDA	-	Agjencioni Ndërkombëtar për Zhvillim dhe Bashkëpunim

## Përmbajtja

	Faqe
<b>H Y R J E</b> .....	5
<b>1 Konsumi i përgjithshëm në Kosovë 2009 - 2011</b> .....	6
1.1 Trendët e konsumit.....	6
1.2 Shpërndarja e konsumit sipas grupeve të konsumit .....	6
<b>2 Konsumi i ekonomive familjare në Kosovë 2009–2011</b> .....	8
2.1 Konsumi kryesor (pesë grupet më të mëdha).....	9
2.2 Ushqimi dhe pijet joalkoolike.....	9
2.3 Banimi.....	10
2.4 Transporti.....	11
2.5 Veshmbathjet .....	11
2.6 Alkooli dhe duhani .....	12
2.7 Mobiliet .....	13
2.8 Shëndetësia .....	13
2.9 Komunikimi .....	14
2.10 Rekreacioni .....	14
2.11 Arsimi.....	15
2.12 Hotele dhe restorante .....	15
2.13 Mallrat dhe shërbime të tjera .....	16
<b>3 Të hyrat private në Kosovë 2009 - 2011</b> .....	17
3.1 Të hyrat kryesore të ekonomive familjare.....	17
3.2 Burimet e të hyrave individuale.....	18
3.3 Të ardhurat sipas strukturës gjinore.....	19
<b>4 Konkluzione</b> .....	20
<b>Shtojcat</b> .....	21





## H Y R J E

ABEF është një vrojtim statistikor që kryhet për të marrë të dhëna mbi shpenzimet për konsum, vetëkonsum, të ardhurat e familjeve dhe kushtet bazë socio-ekonomike në të cilin familjet jetojnë. Anketa siguron gjithashtu të dhëna mbi disa tregues të rëndësishëm në lidhje me kushtet e jetesës (banimin, posedimin e pajisjeve afatgjata në familje, kushtet e ngrohjes, udhëtimet dhe/ose pushimet vjetore), si edhe të dhëna mbi karakteristikat bazë demografike, ekonomike dhe sociale të familjeve.

Të dhënat e mbledhura nga ABEF do të sigurojnë gjithashtu informacion mbi nivelin e jetesës, masën dhe përbërjen e shpenzimeve dhe konsumit total të familjeve dhe karakteristika socio-ekonomike të tyre. Një nga objektivat specifike të Anketës së Buxhetit të Familjes është marrja e të dhënave të nevojshme për vlerësimin e peshave të cilat përdoren për llogaritjen e indeksit të çmimeve të konsumit. Gjithashtu, kjo anketë siguron të dhëna që do të përdoren si një input për matjen e konsumit privat në Llogaritë Kombëtare (LLK) të familjeve si dhe për analizimin e mirëqenies dhe varfërisë në nivel vendi brenda periudhës kohore të përcaktuar.

Të dhënat janë mbledhur në tërë Kosovën gjatë një viti duke përfshirë 2.400 ekonomi familjare, të zgjedhura sipas metodës së rastit dhe në pajtim me standardet e Bashkimit Evropian (BE) dhe praktikat më të mira ndërkombëtare. Shkalla e përgjigjeve është rreth 80 përqind nëse ekonomitë familjare të zëvendësuara janë konsideruar se nuk kanë dhënë përgjigje.

Progresi ekonomik në vitet e fundit do të definohej si përmirësim i kushteve të jetesës në krahasim me periudhën menjëherë pas luftës. Në këto rrethana, ABEF është e mirëseardhur për matjen e standardit jetësor, për ofrimin e të dhënave për Bruto Produktin Vendor (BPV) si dhe fitimin e ponderave të çmimeve konsumuese.

Mostra e ABEF ka shtrirje në zonat urbane dhe rurale, në tërë territorin e Kosovës. Përpunimi dhe analizimi i të dhënave është bërë përmes programeve ACCESS dhe STATA. Pyetësori përmbante informata mbi përbërjen demografike të ekonomisë familjare duke përfshirë të dhëna individuale për secilin anëtar të ekonomisë familjare, si dhe të ardhurat, konsumin dhe shpenzimet, kushtet e banimit, aktivitete në biznese dhe bujqësi, qasjen në infrastrukturën themelore dhe në shërbimet publike, etj.

## 1 Konsumi i përgjithshëm në Kosovë 2009 - 2011

Ky publikim paraqet të dhënat makroekonomike të ABEF për vitet 2009 - 2011. Në disa raste rezultatet ndryshojnë nga Llogaritë Kombëtare (LLK-të), pasi që LLK-të plotësohen më disa burime tjera të të dhënave (si p.sh. të dhëna prej doganave, të dhëna nga importi dhe të dhëna tjera nga prodhimi vendor) dhe bëjnë disa përshtatje.

Të dhënat janë grumbulluar sipas standardit ndërkombëtar të Klasifikimit të Konsumit Individual sipas Qëllimit (KKIQ). Më një mostër paksa më të vogël rezultatet duhet të konsiderohen si të përafërta.

### 1.1 Trendët e konsumit

Sipas rezultateve të ABEF 2011, vërehet një zbritje e lehtë prej 0.5 përqind të konsumit të përgjithshëm krahasuar me vitin 2010, si dhe zbritje prej 1 përqind të konsumit për ekonomitë familjare dhe konsumit për kokë banori.

**Tabela 1: Konsumi i përgjithshëm në Kosovë 2009 – 2011**

Viti	Gjithsej në Milion €	Konsumi për ekonomi familjare €	Konsumi për banor €
2009	1.911	6.847	1.161
2010	1.937	7.110	1.226
2011	1.928	7.010	1.210

### 1.2 Shpërndarja e konsumit sipas grupeve të konsumit

Pjesa më e madhe e buxhetit të ekonomive familjare në vitin 2011 është shpenzuar në ushqim dhe banim, 38 përqind për ushqim dhe 31 përqind për banim, të konsumit të përgjithshëm. Pjesa tjetër e radhës është shpenzuar për transport 6 përqind dhe për veshmbathje 5 përqind. Në vitin 2011 rreth 7 përqind e konsumit të përgjithshëm përfshinë ushqimin nga prodhimi vetanak.

**Tabela 2: Shpërndarja e konsumit në Kosovë sipas grupeve të konsumit 2009 – 2011 në %**

Konsumi	2009	2010	2011
Ushqimi dhe pijet joalkoolike	36	35	38
Alkool dhe duhan	3	4	4
Veshmbathja	5	6	5
Banimi	36	33	31
Mobiliet	3	3	3
Shëndetësi	3	2	2
Transport	5	6	6
Komunikim	2	2	2
Rekreacion	2	2	2
Edukim	1	1	1
Hotel dhe restorante	1	3	3
Të tjera	3	3	3
<i>Ushqimi i vet-prodhuar nga ekonomitë familjare</i>	7	7	7

Ushqimi në Kosovë dominohet nga buka dhe drithërat, mishi, qumështi, djathi, vezët, që kontribuojnë më shumë se gjysmën e konsumit të ushqimit (në vlerë). Më pas radhiten perimet dhe pijet jo alkoolike.

**Tabela 3: Shpërndarja e konsumit të ushqimit në Kosovë 2009 - 2011 në %**

Konsumi	2009	2010	2011
Buka dhe drithërat	19	19	21
Mishi	18	18	19
Peshku	1	1	1
Qumshti, djathi, vezët	20	19	18
Vajrat dhe yndyrat	4	4	5
Frutat	7	7	6
Perimet	12	12	11
Sheqeri dhe ëmbëlsirat	5	6	6
Produkte tjera ushqimore	5	5	5
Pijet joalkoolike	9	9	8
Ushqimi i përgjithshëm	100	100	100

## 2 Konsumi i ekonomive familjare në Kosovë 2009–2011

Dihet se konsumi është pjesë e rëndësishme e jetës së popullatës, pra niveli i konsumit dhe përmasat e tij janë qenësore për mirëqenien, ndërsa pasuria dhe varfëria varen nga aspekte të tjera në jetë. Të dhënat për konsum merren nga ekonomitë familjare, përderisa të ardhurat fitohen nga individët. Alkooli dhe duhani, veshmbathjet, argëtimi dhe disa gjëra tjera specifike mund të konsumohen individualisht, por pjesa më e madhe, si ushqimi, banimi dhe furnizimi shfrytëzohen së bashku nga pjesëtarët e ekonomive familjare.

Konsumi klasifikohet sipas Standardit të Klasifikimit të Konsumit Individual sipas Qëllimit (KKIQ) në harmonizim me Llogaritë Kombëtare dhe Indeksin e Çmimeve të Konsumit. Përveç disa përmirësimeve, standarde të njëjta janë aplikuar gjatë viteve, duke e bërë atë të krahasueshëm më lehtë gjatë kohës.


Shumica e konsumit bazohet në mallrat e blera dhe shërbimet e paguara gjatë periudhës së referuar, dhe një pjesë më e vogël në mallrat të vetëprodhuara. Periudha e referuar është një muaj për konsumin ditor (të mbështetur me mbajtjen e shënimeve) dhe 12 muajt e fundit për mallrat e qëndrueshme.

Në këtë dokument ne do të fokusohemi në nivelin e konsumit për grupe të ndryshme të konsumit (ushqim, veshmbathje, banim, etj.) dhe pjesëmarrjen e tyre në konsumin e përgjithshëm. Ekonomitë familjare me arsim të lartë dhe ekonomitë familjare urbane mund të shihen si treguese për zhvillimin e ardhshëm të konsumit, pasi që gjithnjë e më shumë njerëzit po arsimohen dhe Kosova është duke u urbanizuar.

Shifrat në tekst janë rrumbullakuar që të sinjalizojnë se një mostër anketë mund t'i japë vetëm vlera të përafërta.

Konsumi për ekonomi familjare gjatë vitit 2011 në Kosovë ka qenë 7.010 €, nga kjo vërehet se ka pasur zbritje prej 0.5 përqind në krahasim me vitin 2010. Në ekonomitë familjare në vendbanimet urbane si dhe ato rurale zbritja e konsumit ka qenë rreth 1 përqind.


**Graf. 1: Konsumi i përgjithshëm vjetor i ekonomive familjare sipas lokalitetit 2009 – 2011**



## 2.1 Konsumi kryesor (pesë grupet më të mëdha)

Siç vërehet në Graf. 2 pesë kategoritë kryesore të konsumit më të lartë (ushqimi, banimi, transporti, veshmbathjet, si dhe alkooli dhe duhani) paraqesin 84 përqind të konsumit të përgjithshëm. Shtatë kategoritë tjera të konsumit e ndajnë 16 përqind të konsumit.

**Graf. 2: Pesë kategoritë kryesore të konsumit të ekonomive familjare sipas lokalitetit, % e përgjithshme 2009 - 2011**




## 2.2 Ushqimi dhe pijet joalkoolike

Pjesa më e madhe e buxhetit të ekonomive familjare shfrytëzohet për ushqim dhe pijet joalkoolike dhe është llogaritur 2.665 € për vitin 2011 apo 38 përqind të konsumit të përgjithshëm. Shpenzimet për ushqim dhe pijet joalkoolike në ekonomitë familjare paraqesin rritje rreth 6 përqind krahasuar me vitin 2010.


Përgjatë tri viteve të fundit vërehet një rritje graduale e konsumit për ushqim dhe pije joalkoolike.

**Graf. 3: Konsumi vjetor i ushqimit dhe pijeve joalkoolike nga ekonomitë familjare sipas lokalitetit 2009 - 2011 në €**



Të dhënat e paraqitura në Graf. 4 tregojnë se ushqimi dhe pijet joalkoolike përbëjnë komponentin kryesor të konsumit. Në Kosovë pjesëmarrja e ushqimit dhe pijeve joalkoolike në konsum ka pasur rritje nga 35 përqind në vitin 2010 në 38 përqind në vitin 2011. Trendi i rritjes është paraqitur në total dhe po ashtu edhe në zona urbane dhe rurale.


**Graf. 4: Pjesëmarrja e ushqimit dhe pijeve joalkoolike në konsumin e përgjithshëm sipas lokalitetit 2009 - 2011 në %**



### 2.3 Banimi

Banimi përbën pjesën e dytë më të madhe të buxhetit të ekonomive familjare me 2.198 € apo 31 përqind të buxhetit të ekonomive familjare, që paraqet një rënie prej rreth 7 përqind krahasuar me vitin 2010. Është vrejtur rënie edhe sipas lokalitet, 4 përqind në vendbanime urbane dhe në ato rurale rreth 9 përqind krahasuar me vitin 2010. Pjesa më e madhe e banimit është “qiraja e vlerësuar”. Një pjesë e vogël e ekonomive familjare paguajnë qira. Ushqimi dhe pijet joalkoolike dhe banimi së bashku përbëjnë më shumë se dy të tretat apo 69 përqind të buxhetit të ekonomive familjare.


**Graf. 5: Shpenzimet për banim të ekonomive familjare sipas lokalitetit 2009 - 2011 në €**



## 2.4 Transporti

Transporti në vitin 2011 në krahasim me vitin 2010 ka pasur rënie prej 6 përqind. Pjesa e buxhetit e ndarë për transport në vitin 2011 ka qenë 5 përqind për ekonomitë familjare urbane ndërsa 6 përqind për ato rurale.


**Graf. 6: Shpenzimet e transportit të ekonomive familjare sipas lokalitetit 2009 - 2011 në €**



## 2.5 Veshmbathjet

Një ekonomi familjare në vitin 2011 mesatarisht ka shpenzuar 350 € për veshmbathje apo 5 përqind të buxhetit, që paraqet rënie prej rreth 11 përqind në krahasim me vitin 2010. Në vendbanimet urbane rënie ka qenë 9 përqind e në rurale rreth 13 përqind. Siq shihet në graf 7 rënie kanë pësuar të gjitha grupet.


**Graf. 7: Shpenzimet për veshmbathje të ekonomive familjare sipas lokalitetit 2009 - 2011 në €**



## 2.6 Alkooli dhe duhani

Në buxhetin e përgjithshëm të ekonomisë familjare në vitin 2011 alkooli dhe duhani marrin pjesë rreth 4 përqind, apo 259 € në vit. Është e evidente një rritje e lehtë prej 2 përqind të shpenzimeve për konsum të alkoolit dhe duhanit në krahasim me vitin 2010. Rritja ka qenë edhe në vendbanime rurale prej 7 përqind, kurse në ato urbane kemi rënie reth 4 përqind.

**Graf. 8: Konsumi i Alkoolit dhe duhanit të ekonomive familjare sipas lokalitetit 2009 - 2011, në €**



**Tabela 4: Përqindja e duhanpirësve në popullatë në vitin 2011 sipas gjinisë dhe konsumit ditor të cigareve, % e popullatës në moshën 10 vjeçare dhe më të moshuara**

Numri i cigareve	Meshkujt (%)		Femrat (%)		Të gjithë (%)	
	2010	2011	2010	2011	2010	2011
1 deri 10	2	1	1	1	2	1
11 deri 20	18	18	3	3	11	10
21+	3	3	0	0	2	2
Përqindja e duhanpirësve	23	22	4	4	15	13




## 2.7 Mobiliet

Gjatë viteve 2009, 2010 dhe 2011 ka pasur ndryshueshmëri në shpenzime për mobilie. Në vendbanime urbane vërehet rritje konstante prej vitit në vit, ndërsa në vitin 2011 kemi rënie në ato rurale dhe në total.

Në vitin 2011 ekonomitë familjare mesatarisht kanë shpenzuar rreth 235 € në vit, apo 4 përqind më pak krahasuar me vitin 2010.


**Graf. 9: Mobiliet sipas lokalitetit 2009 - 2011 në €**



## 2.8 Shëndetësia

Shpenzimet për shëndetësi paraqesin një rënie konstante prej vitit në vitë. Në vendbanimet urbane në vitin 2011 krahasuar me vitin 2010 ka qenë një rënie prej 7 përqind, ndërsa në vendbanime rurale ka pasur rritje prej 4 përqind.


**Graf.10: Shpenzimet për shëndetësi të ekonomive familjare sipas lokalitetit 2009 - 2011, në €**



## 2.9 Komunikimi

Në vitin 2011 shpenzimet për komunikim kanë pasur një rritje prej 5 përqind krahasuar me vitin 2010. Në vendbanime urbane po vërehet rritja e shpenzimeve për komunikim ndërsa në ato rurale nuk ka ndryshime të mëdha.

**Graf. 11: Shpenzimet e komunikimit të ekonomive familjare sipas lokalitetit 2009 - 2011, në €**




## 2.10 Rekreacioni

Niveli i shpenzimeve për rekreacion për ekonomitë familjare në nivel të Kosovës, gjatë viteve 2009-2011 ka pasur rritje konstante.

Në krahasim me vitin 2009 në vitin 2010 ekonomitë familjare në vendbanime urbane kanë shpenzuar më pak për rekreacion, ndërsa në vitin 2011 - vërehet një rritje prej 9 përqind krahasuar me vitin 2010. Në vendbanime rurale shpenzimet për rekreacion kanë shënuar rritje graduale përgjatë viteve.


**Graf. 12: Shpenzimet për rekreacion sipas lokalitetit 2009- 2011, në €**



## 2.11 Arsimi

Shpenzimet për arsim kanë qenë më të larta në vitin 2011 në krahasim me vitin 2010 në total dhe vendbanime rurale, por në vendbanime urbane vërehet një rënie e vogël prej 2 përqind.


**Graf. 13: Shpenzimet për arsim të ekonomive familjare sipas lokalitetit 2009 - 2011, në €**



## 2.12 Hotele dhe restorante

Në vitin 2011 krahasuar me vitin 2010, shpenzimet për hotele dhe restorante kanë shënuar një rënie në total prej 13 përqind dhe në vendbanime urbane 23 përqind, mirëpo në vendbanime rurale ka qenë një rritje rreth 14 përqind.


**Graf. 14: Shpenzimet për hotele dhe restorante të ekonomive familjare sipas lokalitetit 2009 - 2011, në €**



## 2.13 Mallrat dhe shërbime të tjera

Ky grup është një përzierje e shpenzimeve për mallra dhe shërbime për rregullim të flokëve, mallra për nevoja personale, shpenzime për sigurime dhe shpenzime tjera financiare. Ekonomitë familjare në vitin 2011 krahasuar me vitin 2010 kanë pasur një rënie të shpenzimeve të tjera në të gjitha grupet, në total prej 3 përqind, në vendbanime urbane rreth 4 dhe në ato rurale rreth 3 përqind.

**Graf. 15: Shpenzimet tjera të ekonomive familjare sipas lokalitetit 2009 - 2011, në €**



### 3 Të hyrat private në Kosovë 2009 - 2011

#### 3.1 Të hyrat kryesore të ekonomive familjare

Rrogat nga sektori publik janë burimi më i rëndësishëm i të hyrave në Kosovë dhe janë burimi kryesor për një të katrën e ekonomive familjare.

Burimi tjetër i rëndësishëm janë rrogat nga sektori privat si dhe bizneset. Pothuajse një nga dhjetë ekonomitë familjare jeton nga paratë e dërguara nga jashtë (remitenca).

Shumica e ekonomive familjare kanë burime të përziera të të hyrave, prandaj të hyrat e tanishme japin një pasqyrë të ndryshme.

**Tabela 5: Burimi kryesor i të hyrave për ekonomitë familjare në Kosovë, % e ekonomive familjare**

Burimi i të hyrave	2010	2011
Rrogat dhe pagat nga sektori publik	26	25
Rrogat dhe pagat nga sektori privat	21	22
Bujqësi	6	7
Të ardhurat nga mëditjet <sup>1</sup>	8	9
Biznese të tjera të ekonomive familjare	14	12
Pensionet	8	8
Të hollat e dërguara nga jashtë	9	9
Të hollat e dërguara nga Kosova	1	0
Ndihma sociale - Kategori I	3	4
Ndihma sociale - Kategori II	2	2
Të tjera <sup>2</sup>	2	2
<b>Totali në %</b>	<b>100</b>	<b>100</b>

<sup>1</sup> Të hyrat nga aktivitete të përkohshme.

<sup>2</sup> Të tjera – Burimi i të hyrave jo të përcaktuara në kategoritë më lartë.

### 3.2 Burimet e të hyrave individuale

Burimi kryesor i të hyrave janë rrogat nga punësimi i rregullt që përbëjnë rreth gjysmën e të hyrave të përgjithshme.

Burim i dytë janë të hyrat neto nga bizneset që përbëjnë 13 përqind të të hyrave të përgjithshme dhe nga bujqësia 7 përqind. Rreth 7 përqind janë fituar nga puna e përkohshme.

Burimi tjetër i rëndësishëm janë paratë e gatshme të dërguara nga jashtë (remitenca) nga pjesëtarët e ekonomive familjare 2 përqind më një shtesë prej 9 përqind nga persona tjerë jashtë vendit. Pensionet nga Kosova përbëjnë 5 përqind dhe pensionet nga jashtë 3 përqind.

Rrogat nga punësimi i rregullt janë më të rëndësishme për femrat sesa për meshkujt. Paratë e gatshme nga jashtë përbëjnë burimin e dytë më të rëndësishëm të të ardhurave për femrat (16 përqind të femrave) krahasuar me vetëm 8 përqind për meshkujt, ndërsa burimi i tretë më i rëndësishëm për femrat janë pensionet nga Kosova me 12 përqind krahasuar me vetëm 4 përqind për meshkuj.

**Tabela 6: Burimet e të hyrave individuale në Kosovë, viti 2011, % e të hyrave**

Burimi i të hyrave	Meshkuj	Femra	Të gjithë
Rrogat dhe pagesat e fituara në Kosovë, neto pa tatim	46	58	48
Të ardhurat nga mëditjet	8	0	7
Qiraja, dividendë, interesi (nga kursimi në bankë)	3	1	3
Benefitet për mirëqenie sociale	1	2	2
Pensionet nga Kosova	4	12	5
Pensionet nga jashtë Kosovës	3	3	3
Neto të ardhurat nga biznesi vetanak në Kosovë	15	4	13
Para të gatshme të dërguara nga jashtë nga anëtarët aktual/prezent/(pagat, transferet, etj)	2	2	2
Para të gatshmet dërguara nga diaspora nga persona të tjera	8	16	9
Të hyrat nga bujqësia	9	1	7
Të tjera	1	1	1
Totali në %	100	100	100
Totali në milion €	1.251	256	1.507

Arsimimi ka ndikim kryesor në burimet e të hyrave. Arsimimi më i madh shpie në më shumë të ardhura nga punësimi i rregullt. Ata me shkollë fillore apo më pak, në masë të konsiderueshme duhet të jetojnë nga mbështetja nga jashtë, pensionet, bujqësia, mëditjet dhe biznesi vetanak.

**Tabela 7: Burimet e të hyrave sipas nivelit më të lartë të arsimimit, viti 2011 (%)**

Burimi i të ardhurave	Me arsim fillor	Me arsim të mesëm	Me universitet e më të lartë
Pagat nga punësimi i rregullt	21	50	77
Të ardhurat nga mëditjet	9	8	1
Qiraja, dividendë, interesi (nga kursimi në bankë)	3	3	3
Benefitet për mirëqenie sociale	4	1	0
Pensionet nga Kosova	14	2	2
Pensionet nga jashtë Kosovës	7	2	0
Neto të ardhurat nga biznesi vetanak në Kosovë	8	18	10
Para të gatshmet dërguara nga jashtë nga anëtarët aktual/prezent/(paqat.transferet. eti)	2	2	1
Para të gatshme të dërguara nga diaspora nga persona të tjerë	16	7	4
Të hyrat nga bujqësia	14	6	2
Të tjera	2	1	0
<b>T o t a l i në %</b>	<b>100</b>	<b>100</b>	<b>100</b>

### 3.3 Të ardhurat sipas strukturës gjinore

Femrat kanë të hyra më të ulëta në krahasim me meshkujt, si grup dhe si mesatare individuale. Si shpjegim mund të jetë vëllimi i ndryshëm i punëve sesa pagat e padrejta. Prej të hyrave mesatare nga punësimi 12 mujor prej 51 përqind, meshkujt fitojnë pothuajse 8 përqind më shumë se femrat.

**Tabela 8: Të ardhurat mesatare vjetore sipas gjinisë për të punësuarit me punësim 12 mujor, në €**

Të ardhurat	Paga vjetore mesatare e meshkujve me punësim 12 mujor	Paga vjetore mesatare e femrave me punësim 12 mujor	Përqindja e të punësuarëve me punësim 12 mujor
Të ardhurat për punësim 12 mujor	3.787 €	3.517 €	51%
Të punësuarit me arsim fillor 12 mujor	3.109 €	2.402 €	55%
Të punësuarit me arsim të mesëm 12 mujor	3.590 €	3.142 €	52%
Të punësuarit me arsim të lartë 12 mujor	4.619 €	4.056 €	52%

## 4 Konkluzione

Edhe shumë vite pas luftës shoqëria kosovare ka mungesë të informacioneve në fushën e standardit jetësor të ekonomive familjare dhe Anketa e Buxhetit të Ekonomive Familjare është e mirëseardhur për ofrimin e këtyre të dhënave. Qëllimi kryesor i këtij raporti është vlerësimi i konsumit të ekonomive familjare, të ardhurat dhe kushtet e jetesës në nivel vendi për vitin 2011. Ky raport pasqyron të dhëna për vitet 2009-2011.

Analizat e ABEF 2011 tregojnë se në Kosovë konsumi i përgjithshëm ka pasur zbritje prej 0.5%, ndërsa tek konsumi për ekonomi familjare dhe për kokë banori rreth 1%. (Tabela 1). Ekonomitë familjare në Kosovë pjesën më të madhe të konsumit e kanë shpenzuar për ushqim, banim, transport, veshmbathje (Tabela 2). Shpërndarja e ushqimit në konsum ka qenë ngjashëm me disa vite më parë ku dominon konsumi i bukës dhe drithërave, mishi, qumështi, djathi dhe vezët. (Tabela 3)

Në konsumin e familjes kosovare është i rëndësishëm konsumi vetanak, dhe trendi i konsumit vetanak në ekonominë familjare gjatë tri viteve është i pandryshueshëm (7 %).

Tek ekonomitë familjare urbane dominon konsumi për banim, arsim, hotel dhe restorante, rekreacion dhe komunikim, ndërsa tek ato rurale dominon konsumi për ushqim, transport, dhe mobilje (Tabela A1).

Ekonomitë familjare në të cilat kryefamiljari ka arsim të lartë krahasuar me ato ku ai ka shkollim të mesëm, fillor apo më pak po e rrisin pjesën e buxhetit për arsim dhe rekreacion (Tabela A1).

Pjesë e këtij raporti janë edhe burimi kryesor i të hyrave të ekonomive familjare dhe të hyrave individuale (Kapitulli 3). Sipas rezultateve të ABEF 2011 burim i rëndësishëm i të hyrave të ekonomive familjare janë rrogat nga sektori publik dhe ai privat, pastaj të hyrat nga biznesi vetanak dhe pensionet nga Kosova dhe jashtë (Tabela 5).

Siq vërehet në Tabelën 6 Burimet e të hyrave individuale, pjesën më të madhe të të hyrave e përbëjnë rrogat nga punësimi i rregullt që përfaqësojnë rreth gjysmën e të hyrave të përgjithshme, ndërsa burimi i dytë janë të hyrat nga bizneset dhe ato nga bujqësia. Po ashtu rol të rëndësishëm kanë edhe paratë e dërguara nga jashtë (remitencat) dhe pensionet.

Te të hyrat individuale vërehet se personat me arsim më të lartë burim kryesor e kanë pasur punësimin e rregullt, ndërsa ata me arsim fillor apo më pak orientoheshin tek mbështetja nga jashtë, pensionet, bujqësia, mëditjet dhe biznesi vetanak. (Tabela 7)



## Shtojcat

**Tabela A1: Konsumi vjetor i ekonomive shtëpiake në Kosovë 2009-2011 sipas konsumit, lokalitetit dhe arsimit të kryefamiljarëve të ekonomive familjare, € dhe % konsumit të përgjithshëm**

Vitet	Ushqimi	Alkool dhe duhan	Veshmbathje	Banim	Mobilje	Shëndetësi	Transport	Komunikim	Rekreacion	Arsim	Hotele dhe restorante	Të tjera	Totali €
<b>Kosovë</b>													
2009	2 442	231	354	2 432	221	176	361	107	106	47	188	183	6 847
2010	2 519	255	397	2 352	245	175	422	141	114	59	226	205	7 110
2011	2 665	259	352	2 198	235	173	396	148	123	66	197	198	7 010
<b>Urbane</b>													
2009	2 344	241	340	2 967	223	176	310	126	155	60	292	193	7 429
2010	2 432	267	384	2 759	227	183	355	160	140	86	389	206	7 588
2011	2 567	257	350	2 652	228	170	358	175	153	84	300	198	7 492
<b>Rurale</b>													
2009	2 512	223	364	2 045	220	175	398	93	70	37	112	117	6 426
2010	2 582	245	405	2 059	258	169	469	128	95	40	109	204	6 763
2011	2 734	261	354	1 879	240	176	423	129	102	53	124	198	6 671
<b>Kryefamiljari me arsim fillor apo më pak</b>													
2009	2 279	216	319	2 126	198	154	322	89	56	23	84	148	6 013
2010	2 392	242	346	2 057	221	177	347	113	71	30	91	188	6 275
2011	2 586	271	305	1886	210	172	318	126	81	43	85	182	6 266
<b>Kryefamiljari me arsim të mesëm</b>													
2009	2 409	230	352	2 417	220	143	367	103	104	48	160	199	6 752
2010	2 464	277	379	2 437	253	161	425	144	156	71	236	210	7 185
2011	2 666	266	369	2278	246	162	409	151	131	58	193	194	7 122
<b>Kryefamiljari me arsim të lartë</b>													
2009	3 133	263	570	3 764	312	271	526	201	352	140	821	274	10 625
2010	2 864	224	558	3 005	302	177	600	215	209	109	564	253	9 080
2011	2 882	210	438	2 849	273	205	576	201	220	150	518	250	8 773

**Tabela A2: Konsumi vjetor i ekonomive familjare në Kosovë 2009-2011, sipas 5 rupeve kryesore të konsumit, lokalitetit dhe arsimit të kryefamiljarëve të ekonomive familjare, në %**

Vitet	Ushqimi	Alkool dhe duhan	Veshmbathje	Banim	Mobilje	Shëndetësi	Transport	Komunikim	Rekreacion	Arsim	Hotele dhe restorante	Të tjera	5 grupet kryesore <sup>1</sup> %
<b>Kosovë</b>													
2009	36	3	5	36	3	3	5	2	2	1	1	3	85%
2010	35	4	6	33	3	2	6	2	2	1	3	3	84%
2011	38	4	5	31	3	2	6	2	2	1	3	3	84%
<b>Urbane</b>													
2009	32	3	5	40	3	2	4	2	2	1	4	3	83%
2010	32	4	5	36	3	2	5	2	2	1	5	3	82%
2011	34	4	5	35	3	2	5	2	2	1	4	3	83%
<b>Rurale</b>													
2009	39	3	6	32	3	3	6	1	1	1	2	3	86%
2010	38	4	6	30	4	3	7	2	1	1	2	3	85%
2011	41	4	5	28	4	3	6	2	1	1	2	3	84%
<b>Kryefamiljari me arsim fillor apo më pak</b>													
2009	38	4	5	35	3	3	5	1	1	0	1	2	87%
2010	38	4	6	33	4	3	6	2	1	0	1	3	87%
2011	41	4	5	30	3	3	5	2	2	1	1	3	85%
<b>Kryefamiljari me arsim të mesëm</b>													
2009	36	3	5	36	3	2	5	2	2	1	2	3	85%
2010	34	4	5	34	4	2	6	2	2	1	3	3	83%
2011	37	4	5	32	3	2	6	2	2	1	3	3	84%
<b>Kryefamiljari me arsim të lartë</b>													
2009	29	2	5	35	3	3	5	2	3	1	8	3	76%
2010	32	2	6	33	3	2	7	2	2	1	6	3	81%
2011	33	2	5	32	3	2	7	2	3	2	6	3	79%

<sup>1</sup> Këtu janë përfshirë pesë grupet kryesore të konsumit (ushqimi, banimi, transporti, veshmbathjet, alkooli dhe duhani)



# Agjencia e statistikave të Kosovës

*përshkrim i shkurtër*

**Agjencia e statistikave të Kosovës** është institucion profesional i cili merret me grumbullimin, përpunimin dhe publikimin e të dhënave zyrtare të statistikave. Si i tillë vepron që nga viti 1948 i cili ka kaluar nëpër disa faza historike, i strukturuar sipas rregullimit shtetëror të asaj kohe.

Më 2 Gusht 1999, Agjencioni ka rifilluar punën e vet profesionale (pas 9 viteve të ndërprerjes të të gjitha serive statistikore në dëm të interesit të Kosovës), si institucion i pavarur në kuadër të Ministrisë së Administratës Publike. Që nga data 12.12.2011 ky Agjencion vepron në kuadër të Kryeministrisë së Kosovës. Agjencioni financohet nga Buxheti i Konsoliduar i Kosovës por edhe nga donatorët për projekte të veçanta dhe për ndihmë teknike profesionale.

**Agjencia e statistikave të Kosovës** vepron sipas Ligjit Nr. 04/L-036 i cili ka hyrë në fuqi me 12.12.2011. Plani zhvillimor strategjik 2009-2013 është në implementim afatmesëm për zhvillimin e sistemit statistikor në korrelacion me Statistikat e Bashkësisë Evropiane (EUROSTAT-it).

**Agjencia e statistikave të Kosovës** ka këtë strukturë organizative: **Departamentet prodhuese;** (Departamenti i statistikave ekonomike dhe llogarive kombëtare, Departamenti i statistikave të popullsisë, Departamenti i statistikave të bujqësisë dhe mjedisit, dhe Departamenti i statistikave sociale. **Departamentet mbështetëse;** (Departamenti i metodologjisë dhe teknologjisë informative, Departamenti i administratës. **Në kuadër të Agjencionit vepron edhe;** Zyra për regjistrimin e popullsisë ekonomike familjare dhe banesave si dhe **Zyrat Rajonale;** Gjakovë, Gjilan, Mitrovicë, Pejë, Prizren, Prishtinë, dhe Ferizaj

Numri i të punësuarve dhe buxheti akoma janë të limituar. Të punësuar janë gjithsej 134 punëtorë, prej tyre, 96 (71.6%) në seli të Entit, gjersa në Zyrat Rajonale, 38 (28.4%), Enti ka ketë strukture kualifikuese, 65.4% me shkollim universitar ndaj 34.6% me shkollim të mesëm.

Kemi bashkëpunim profesional dhe teknik me të gjitha Ministrinë e Qeverisë së Kosovës, sidomos me Ministrin e Ekonomisë dhe Financave, Bankën Qendrore të Kosovës, me institucionet ndërkombëtare, EUROSTAT-in, Fondin Monetar Ndërkombëtare, Bankën Botërore, SIDA e Suedisë, DFID, UNFPA, UNDP, UNICEF, dhe me statistikave të shteteve në rajon.

**Agjencia e statistikave të Kosovës** mbulon gati krejtësisht territorin e Republikës së Kosovës, duke u organizuar në strukturimin e qarqeve statistikore dhe njësive raportuese si njësi bazë dhe të vetme në shkallë vendi nga të cilat merr informatat e dorës së parë. Te gjitha anketat e zhvilluara në terren përdorin shtrirjen e mostrës në këto qarqe statistikore por edhe metodologjinë sipas rekomandimeve ndërkombëtare. Gjatë grumbullimit të të dhënave statistikore dhe raporteve nga njësitë raportuese angazhohen; profesionistë, teknikë, administratorë, civilë të zyrave të vendit, regjistruar terreni nga Zyrat Rajonale etj.

Kemi realizuar me sukses në vitin 2011 projektin e Regjistrimit të Popullsisë Ekonomike Familjar dhe banesave, i cili regjistrim nuk është realizuar që nga viti 1981. Rezultatet e fituara nga ky regjistrim do të kenë një rol të rëndësishëm për hartimin e Politikave zhvillimore.

**Misioni Agjencionit;** të përmbush nevojat e shfrytëzuesve me të dhëna statistikore kualitative, objektive, në kohë dhe hapësirë në mënyrë që shfrytëzuesit të kenë bazë të besueshme që të bëjnë analiza të rregullta në interes të planifikimit dhe zhvillimit gjatë hartimit të projekteve në shkallë vendbanimi, komune dhe vendi. Të përkrah institucionet qeveritare, institutet, shkencën, akademinë, bizneset si dhe hulumtuesit e pavarur etj. në mënyrë që t'u sigurojë informata të duhura për vendim-marrësit si dhe përdoruesit tjerë në Kosovë.

- o **Adresa: AGJENCIA E STATISTIKAVE TË KOSOVËS,**  
Rr. "Zenel Salihu", nr. 4, 10000 Prishtinë
- o **Telefoni:** +381 (0) 38 200 31 143  
Kryeshafi Ekzekutiv: +381 (0) 38 200 31 112
- o **Fax::** +381 (0) 38 235 033
- o **E-mail:** [social@ks-gov.net](mailto:social@ks-gov.net)
- o **Ueb-faqe:** <http://esk.rks-gov.net>